

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “20Twenty1” SH.P.K.

Sot më datë 28 Shtator 2022, **Znj. Blerta Isa**, e bija e Agim, i datëlindjes 31 Janar 1985, lindur në Tiranë, shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “20Twenty1” sh.p.k. si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “20Twenty1” sh.p.k., nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm **Znj. Blerta Isa**.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “20Twenty1” sh.p.k. do të jetë: Bar kafe, restorant, piceri, sherbim katering, tabakino. Tregti me pakice artikuj ushqimor (patatina, etj). Transport per nevojat e aktivitetit dhe cdo aktiviteti tjetër te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Selia e shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë “20Twenty1” sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga Myslym Shyri, Pall 54, Shk 1.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “20Twenty1” sh.p.k. është 100 000 (njëqind mijë) Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “20Twenty1” sh.p.k. është **Z. Kledi Xhani**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “20Twenty1” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i Vetëm

Blerta ISA

